

L I G J

Nr.8518, datë 30.7.1999

PËR UJITJEN DHE KULLIMIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë kuadrin ligjor për krijimin dhe funksionimin e shoqatave të përdoruesve të ujit, të federatave, të shoqatave të përdoruesve të ujit dhe të bordeve të kullimit;
- b) të përcaktojë kuadrin institucional që t'i shërbejë një politike kombëtare për ujitjen, kullimin, mbrojtjen nga përmbytja dhe erozioni;
- c) të përcaktojë të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë që merren me ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytja dhe erozioni;
- ç) të rregullojë transferimin e të drejtave të përdorimit të sistemeve të ujitjes shoqatave të përdoruesve të ujit dhe federatave të shoqatave të përdoruesve të ujit;
- d) të rregullojë transferimin e të drejtave të përdorimit të sistemeve të kullimit dhe të veprave të mbrojtjes nga përmbytja tek bordet e kullimit.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptimin e këtij ligji termat kanë këto kuptime:

“Shoqatë” është bashkësia e individëve përdorues të ujit, e krijuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

“Mbledhja e shoqatës” është organi kryesor vendimmarrës i shoqatës.

“Përfitues” janë fermerët ose banorët e vendosur në zonat nënujtje të prëcaktuara në këtë nen dhe që përfitojnë nga shërbimet përkatëse.

“Federatë” është bashkimi i shoqatave të përdoruesve të ujit, e krijuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

“Këshill administrativ” është organi i ngarkuar me drejtimin e një shoqate apo federate.

“Bord i kullimit” është person juridik publik i caktuar në përputhje me kreun V të këtij ligji.

“Stacion pompash kullimi” përfshijnë një tërësi elektropompash të vendosura në grup apo të veçanta, linja furnizimi me energji elektrike, linja telefoni dhe nënstacione të lidhura me të, që shërbejnë për kullimin e tokave.

“Vepra të mbrojtjes nga përmbytja” përfshijnë diga të mbrojtjes nga përmbytja dhe ndërtime përgjatë lumenjve dhe rrjedhave të tjera ujore, kanaleve të ujërave të larta, për parandalimin nga përmbytja të tokave bujqësore dhe qendrave rurale.

“Zonë nën ujitje” është një zonë e caktuar gjeografike që furnizohet me ujë nga shoqata ose federata që përdor një/disa sisteme ujitjeje.

“Zonë nën kullim” është një zonë e caktuar gjeografike që përfiton prej një sistemi kryesor kullimi.

“Sistem ujitjeje” është një rrjet ujitës, së bashku me veprat përkatëse hidroteknike, stacion pompash, rrugë, ndërtesa dhe infrastruktura që shoqëron ato, të furnizuar nga një kanal parësor ose një rezervë ujore parësore për ujitjen e një sipërfaqeje toke, duke përfshirë tubacionet dhe kanalet që ujitin e kullojnë vetëm atë sipërfaqe toke. Sistemi i ujitjes përfshin edhe tokën bashkëngjitur me kanalet e ujitjes që lejon përdorimin e tyre.

“Sistem kullimi” është një rrjet kullimi, kanale të ndërtuara dhe kanale natyrore, si dhe me veprat përkatëse hidroteknike dhe infrastruktura, përfshirë këtu stacionet e pompave të kullimit, rrugët dhe ndërtesat. Sistemi i kullimit shërben për të kulluar tokën, përfshirë edhe tokën bujqësore, rrugët dhe zonat urbane. Sistemi kryesor i kullimit përfshin edhe tokën bashkëngjitur me kanalet kullues të ndërtuara dhe atyre natyrore, për të lejuar përdorimin e tyre.

“Kanal kryesor ujitës” nënkupton kanalin që merr ujë nga një lumë kullues, rezervuar ose burime të tjera.

“Departament Mbikëqyrës” është organi mbikëqyrës i ujitjes dhe të kullimit, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 3

Burimet ujore të lumenjve, përrenjve, liqeneve natyrore, të ujëmbledhësve, ujërave nëntokësorë dhe ujërat e sistemeve ujitëse dhe të kullimit, që përdoren për ujitjen e tokave bujqësore, janë pronë e shtetit.

Neni 4

Parimet kryesore

Administrimi i sistemeve të ujitjes, i sistemeve të kullimit dhe i veprave të mbrojtjes nga përmbytja kryhet në përputhje me parimet që vijojnë:

a) Sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë për të nxitur dhe mbrojtur interesat e të gjithë përfituesve.

b) Sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë edhe për të parandaluar erozionin dhe ndotjen, si dhe për të nxitur mbrojtjen e mjedisit.

c) Përfituesit nga sistemet e ujitjes, të kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja, përballojnë shpenzimet e funksionimit dhe të mirëmbajtjes së tyre.

Neni 5

Administrimi i ujitjes dhe kullimit

1. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit është organi kryesor përgjegjës për administrimin e ujitjes dhe të kullimit.

2. Drejtoritë e ujërave në rrethe kryejnë administrimin e ujitjes dhe të kullimit të përcaktur në këtë ligj, derisa administrimi t'u jepet shoqatave, federatave ose bordeve të kullimit.

3. Shoqatat kryejnë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes, që u janë dhënë atyre në përputhje me kreun III të këtij ligji.

4. Federatat kryejnë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kryesore ujitëse, që u janë dhënë atyre në përputhje me kreun IV të këtij ligji.

5. Bordet e kullimit kryejnë detyrat e përcaktuara në këtë ligj, në përputhje me kreun V të këtij ligji.

Neni 6

Kompetencat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit

1. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit:

a) përcakton politikën kombëtare të ujitjes dhe të kullimit;

b) përcakton detyrat, buxhetin dhe planet e punimeve të drejtorive të ujërave të rretheve dhe mbikëqyr funksionimin e tyre;

c) mbikëqyr funksionimin dhe veprimtarinë e shoqatave, të federatave dhe bordeve të kullimit nga ana ligjore dhe financiare;

ç) mbikëqyr infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit nga ana teknike;

d) propozon krijimin e bordeve të kullimit;

dh) autorizon transferimin e sistemeve të ujitjes dhe kanaleve kryesore ujitëse shoqatave dhe federatave;

e) kryen detyrat e tjera të përcaktuara në këtë ligj.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit mund të delegojë detyrat e veta drejtorive të bujqësisë në rrethet përkatëse.

3. Pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit krijohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Ujitjes dhe të Kullimit. Departamenti Mbikëqyrës ka për detyrë:

a) të mbajë regjistrin e shoqatave, të federatave dhe bordeve të kullimit;

b) të këshillojë dhe të udhëzojë shoqatat, federatat dhe bordet e kullimit, me kërkesën e këtyre të fundit për çështje ligjore, teknike dhe financiare;

c) të mbikëqyrë zgjedhjen e këshillave administrativë të shoqatave dhe federatave;

ç) të kryejë kontrole financiare të shoqatave, federatave dhe bordeve të kullimit;

d) të kryejë kontrollin teknik dhe fizik të sistemeve të ujitjes, kanaleve kryesore,

sistemeve kryesore të kullimit dhe veprave mbrojtëse;

dh) të kryejë monitorimin e cilësisë së ujërave të ujitje-kullimit dhe të tokave nën sistemin e këtyre ujërave;

e) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 7

Drejtoritë e ujërave në rrethe

1. Drejtoritë e ujërave në rrethe janë ndërmarrje shtetërore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Ato kryejnë detyrat e parashikuara në këtë nen, derisa këto detyra t'u kalohen shoqatave, federatave ose bordeve të kullimit.

2. Drejtoria e ujërave në rreth ka për detyrë:

a) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kryesore ujitëse dhe furnizimin e shoqatave me ujë për ujitje sipas kontratës;

b) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kryesore të kullimit;

c) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e veprave mbrojtëse nga përmbytja;

ç) kryerjen e shërbimeve të tjera në përputhje me aktet nënligjore.

3. Buxheti vjetor dhe plani i punimeve të drejtorive të ujërave të rretheve miratohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. Fondet për drejtoritë e ujërave në rrethe krijohen me të ardhurat e mbledhura nga furnizimi me ujë për ujitje, nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat e krijuara nga veprimtari të tjera të përfshira në fushën e veprimtarive të këtyre ndërmarrjeve.

4. Tarifat për furnizimin me ujë sipas paragrafit a) të pikës 2 të këtij neni llogariten mbi bazën e sasisë së ujit të furnizuar ose për zonën që është ujitur dhe do të llogaritet në bazë të bisedimeve ndërmjet drejtorive të ujërave në rrethe dhe shoqatave të interesuara. Detyrimi financiar që shoqatat ose federatat do t'i paguajnë drejtorisë së ujërave vendoset mbi bazën e bisedimeve ndërmjet palëve. Kontrata e hartuar në këtë rast përmban të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe sanksionet. Tarifat mbi bazë volumi ose sipërfaqeje do t'i raportohen nga drejtoria e ujërave Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, e cila do të japë miratimin përkatës.

5. Drejtoria e ujërave të rrethit nuk furnizon më ujë drejtpërsëdrejti pronarin ose zotëruesin e tokës, i cili ndodhet brenda zonës nën ujitje të një shoqate.

Kur fermerët nuk janë të organizuar në shoqata, zbatohen tarifa të veçanta, të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

6. Drejtoria e ujërave në rreth, e cila funksionon brenda zonës të një bordi këshillimor kullimi, bashkëpunon ngushtë me të dhe vë në dispozicion të tij kopjen e dokumentacionit ose të të dhënave që ajo ka.

KREU II

INFRASTRUKTURA E UJITJES DHE KULLIMIT

Neni 8

Inventari i sistemeve të ujitjes dhe të kullimit

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit mban inventarin e gjendjes së sistemeve të ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja, të cilat janë pronë shtetërore.

Neni 9

Bazat për transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit

1. Deri në krijimin e bordeve të kullimit sipas kreut V të këtij ligji, transferimi i infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit kryhet në bazë të të drejtës kontraktuale të përdorimit dhe koncensionit. Çdo transferim bëhet me anë të një marrëveshjeje me shkrim, në formën e përcaktuar ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe kujtdo që i transferohet prona. Marrëveshja përmban të drejtat dhe detyrat e palëve për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës.

2. Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit mund të vendosë që transferimet e infrastrukturës të kryhen në bazë:

- a) të një transferimi në përdorim;
 - b) të një marrëveshjeje koncesioni në përputhje me ligjin për koncensionet.
- Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit është institucioni i autorizuar për qëllim të atij ligji.

Neni 10

Transferimi i infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit miraton që:

- a) kanalí kryesor ose rezervuari që i shërben më shumë se një shoqate, t'i transferohet federatës, e cila është krijuar për të shfrytëzuar dhe mirëmbajtur atë kanal ose rezervuar;
- b) kanali kryesor ose një rezervuar, i cili i shërben vetëm për një shoqatë, mund t'i transferohet asaj shoqate;
- c) sistemi ujitës, i cili i shërben një shoqate, t'i kalohet asaj shoqate;
- ç) sistemi kryesor i kullimit t'i kalohet bordit të kullimit;
- d) çdo transferim të bëhet duke iu referuar një planimetrie ose harte, e cila përshkruan kanalin kryesor, rezervuarin, sistemin e ujitjes dhe të kullimit që është objekt transferimi.

Neni 11

Shfrytëzimi i infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit

- 1. Shoqata shfrytëzon sistemin e ujitjes së transferuar në mënyrë të tillë që çdo anëtar

i saj të marrë ujin në kohën e duhur, duke u vënë në pozita të barabarta për sasinë e furnizimit.

2. Shoqata furnizon me ujë sipas kontratës një person, i cili është pronar toke brenda zonës nën ujitje të shoqatës, por që nuk është anëtar i shoqatës. Në përputhje me statutin, shoqata mund të vendosë tarifa për furnizimin me ujë në nivel më të lartë sesa tarifën që paguajnë anëtarët e vet, por jo më shumë se dyfishi i këtyre tarifave.

3. Çdo shoqatë merr masat e nevojshme për të ruajtur dhe mbrojtur çdo sistem ujitjeje që i është transferuar, për të parandaluar ndërhyrjet e paautorizuara në to, duke përfshirë edhe sipërfaqet e tokës bashkëngjitur, të cilat i janë përfshirë atij sistemi.

4. Federata furnizon me ujë sipas kontratës një shoqatë joanëtare të federatës me tarifë më të lartë se ajo që paguajnë anëtarët e federatës, por jo më shumë se dyfishin e kësaj tarife.

5. Çdo federatë merr masat e nevojshme për të ruajtur dhe mbrojtur çdo infrastrukturë që i është transferuar, për të parandaluar ndërhyrjet e paautorizuara, duke përfshirë edhe sipërfaqet e tokës bashkëngjitur, të cilat i janë përfshirë atij sistemi.

6. Çdo federatë dhe shoqatë duhet:

- a) të mirëmbajë dhe të shfrytëzojë infrastrukturën që i është transferuar;
- b) të përmbushë detyrat e saj në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe të rezervave ujore;
- c) të monitorojë sasinë e ujit që përdor gjatë një viti.

KREU III

SHOQATAT E PËRDORUESVE TË UJIT

Neni 12

Krijimi i shoqatave

1. Shoqatat krijohen në bazë vullnetare në përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Çdo person fizik a juridik që ka në pronësi ose në përdorim tokë brenda zonës nën ujitje të një shoqate, ka të drejtën të bëhet anëtar i kësaj shoqate. Ajo dërgon statutin e vet në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe, pas miratimit prej saj, shoqata regjistrohet në gjykatën kompetente.

2. Ndryshimet në statutin e një shoqate bëhen në përputhje me Kodin Civil, me përjashtim të faktit që çdo propozim për ndryshimin e statudit të një shoqate, të miratohet nga mbledhja e përgjithshme, si dhe nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. Shoqata depoziton statutin e ndryshuar në gjykatën kompetente brenda 30 ditëve nga marrja e miratimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit miraton rregullore për procedurat që duhet të ndiqen për krijimin e shoqatave.

Neni 13

Shoqatat hartojnë statutin në përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Detyrat e shoqatës, si dhe të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të shoqatës, përcaktohen në statutin e saj.

Neni 14

Organizimi i shoqatave

1. Organet e shoqatës janë mbledhja e përgjithshme, këshilli administrativ dhe kryetari i tij.
2. Shoqata me më pak së 30 anëtarë nuk ka këshill administrativ dhe detyrat e këtij këshilli kryhen nga kryetari.
3. Shoqata, ka të drejtë të parashikojë në statut krijimin dhe funksionimin e organeve të tjera shtesë si këshilli ekzekutiv, komisioni i kontrollit financiar, si dhe grup arbitrash.

Neni 15

Mbledhja e përgjithshme

1. Mbledhja e përgjithshme është organi kryesor vendimor i shoqatës dhe mbledhet të paktën një herë në vit. Çdo anëtar shoqate gëzon të drejtën të ndjekë mbledhjen e përgjithshme në të gjitha sesionet.
2. Mbledhja e jashtëzakonshme e mbledhjes së përgjithshme thirret nga këshilli administrativ, kur ky i fundit e sheh të nevojshme. Mbledhja thirret me shkrim në bazë të kërkesës së të paktën 20 për qind të anëtarëve të përfaqësuesve të tyre ose siç tregohet në statut.
3. Vendimet e mbledhjes së përgjithshme merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e tyre. Sesionet e mbledhjes së përgjithshme drejtohen nga kryetari i këshillit administrativ të shoqatës, ose në mungesë të tij nga zëvendëskryetari, ose nga një person tjetër i parashikuar në statut.
4. Përveç kompetencave që i njihen sipas Kodit Civil, mbledhja e përgjithshme ka kompetencë të trajtojë çështjet që vijnë:
 - a) Miratimi i bilancit vjetor, i raportit vjetor dhe buxhetit të propozuar.
 - b) Miratimi i planit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të sistemeve ujitës.
 - c) Miratimi i programit të shpërndarjes së ujit dhe planit të ujitjes.
 - ç) Miratimi i nivelit të tarifave që do të mbledhen nga shoqatat, si dhe sanksionet që vendosen prej shoqatës.
 - d) Ndryshime të statutit.
 - dh) Miratimi i rregullores së brendshme dhe i rregullores së funksionimit brenda kuadrit të statutit;.
 - e) Vendime lidhur me bashkimin e shoqatës për anëtarësimin e saj në federatë.

Neni 16

Sistemi me përfaqësim

1. Nëse numri i anëtarëve të shoqatës është i tillë sa që praktikisht është e pamundur të mbahen sesione të mbledhjes së përgjithshme, në përputhje me këtë nen, statuti parashikon krijimin e një sistemi me përfaqësim.
2. Anëtarët, sipas sistemit me përfaqësim, ndahen në grupe të veçanta, ku secili zgjedh

një përfaqësues të grupit përkatës në sesionet e mbledhjes së përgjithshme. Ky përfaqësues voton në emër grupit. Statuti parashikon që çdo përfaqësues të ketë një votë ose që çdo përfaqësues të ushtrojë votat e anëtarëve që ai/ajo përfaqëson. Në rast së përdoret sistemi me përfaqësim, anëtarët e shoqatës gëzojnë të drejtën të ndjekin sesionet e mbledhjes së përgjithshme por nuk kanë të drejtën e votës.

3. Statuti duhet të përcaktojë kohëzgjatjen e mandatit të përfaqësuesve dhe procedurat për zgjedhjen e përfaqësuesve.

Neni 17

Këshilli administrativ

1. Këshilli administrativ jep llogari përpara mbledhjes së përgjithshme për mbikëqyrjen e funksionimit të shoqatës dhe përbëhet prej një minimumi prej tre vetësh.

2. Anëtarët e këshillit administrativ janë anëtarë të shoqatës dhe zgjidhen nga mbledhja e përgjithshme vjetore për një afat deri deri në dy vjet. Anëtarët që plotësojnë afatin mund të rizgjidhen. Askush nuk gëzon të drejtën të paraqesë kandidaturë për t'u zgjedhur, nëse ka ndaj shoqatës detyrime financiare si pagesa, tarifa, sanksione etj.

3. Detyrat e këshillit administrativ janë:

a) Thirrja e sesioneve të mbledhjes së përgjithshme.

b) Përgatitja e projektbuxhetit, e planit të punës dhe planit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes për t'ia kaluar për miratim mbledhjes së përgjithshme.

c) Përgatitja e kontratave në përputhje me buxhetin e miratuar, me planin e punës dhe me planin e shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes.

ç) Marrja dhe largimi nga puna e personelit të shoqatës.

d) Propozimi i çështjeve që do të vendosen nga mbledhja e përgjithshme.

dh) Ndjekja e funksionimit të shoqatës.

e) Ndjekja e procedurave financiare të shoqatës.

ë) Çështje të tjera që janë përcaktuar në statut.

4. Mbledhjet e këshillit administrativ zhvillohen çdo muaj, nëse statuti nuk parashikon ndryshe. Mbledhjet thirren sipas kërkesës së kryetarit ose një të tretës së anëtarëve të këshillit administrativ. Vendimet e këtij këshilli merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm dhe vota e kryetarit është vendimtare në rast barazie votash. Statuti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit administrativ, të cilët duhet të jenë të pranishëm për të arritur shumicën e duhur për fillimin e mbledhjes.

5. Kryetari zgjidhet nga këshilli administrativ ndërmjet anëtarëve të vet ose drejtpërsëdrejti nga mbledhja e përgjithshme prej anëtarëve të shoqatës. Kompetencat dhe detyrat e kryetarit përcaktohen në statut.

Neni 18

Këshilli ekzekutiv

1. Krijimi dhe funksionimi i këshillit ekzekutiv, përbërja e stafit dhe kohëzgjatja e emërimit të tyre përcaktohen në statutin e shoqatës ose me vendim të mbledhjes së përgjithshme.

2. Në këshillin ekzekutiv të një shoqate përfshihen kryetari, sekretari i përgjithshëm,

kryellogaritari, mbikëqyrësi dhe një mjeshtër ujërash. Detyrat, kompetencat dhe përshkrimi i punës së këtyre punonjësve detajohet në statut ose me vendim të mbledhjes së përgjithshme.

Neni 19

Tarifat që paguhen nga anëtarët e shoqatës

1. Statuti i çdo shoqate përcakton tarifat që duhet të paguajë çdo anëtar. Në këto tarifa përfshihen:

- a) Tarifa e ujit për ujitje
- b) Tarifa e kullimit
- c) Kuotë anëtarësie vjetore
- ç) Çdo tarifë tjetër e vendosur nga shoqata

2. Çdo person që është përjashtuar ose i është kërkuar të japë dorëheqjen nga shoqata, në përputhje me nenin 20, detyrohet të paguajë të gjitha tarifat e papaguara dhe detyrimet që i ka shoqatës.

Neni 20

Largimi dhe përjashtimi i anëtarëve

1. Çdo anëtar i një shoqate ka të drejtën të largohet nga shoqata, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon që një e drejtë e tillë nuk ushtrohet deri në fund të stinës së ujitjes. Nëse shoqata bën shpenzime të veçanta për projektimin, ndërtimin, ripajisjen ose funksionimin e një sistemi ujitës si pasojë e anëtarësisë së një personi, ky person nuk mund të largohet nga shoqata derisa të ketë ripaguar shpenzimet në fjalë.

2. Kushdo që shet tokën e vet brenda zonës së ujitjes së një shoqate ose pushon së qeni i vendosur në tokën në fjalë dhe nuk plotëson më kushtet për anëtarësi në shoqatë, sipas nenit 13, duhet të japë dorëheqjen. Përpara shitjes, blerësi dhe shitësi venë në dijeni shoqatën, e cila është përgjegjëse për detyrimet që shitësi duhet t'i shlyejë shoqatës. Blerësi mund të bëhet anëtar i shoqatës, nëse gjithë tarifat dhe pagesat që shitësi i detyrohej shoqatës, janë paguar.

3. Çdo person përjashtohet nga shoqata, në përputhje me statutin, për shkak:

- a) të shkeljeve sistematike të akteve ligjore e nënligjore, të rregullave të brendshme dhe rregulloreve të shoqatës;
- b) të vonesës në pagesën e detyrimeve dhe të tarifave të vendosura nga shoqata;
- c) të refuzimit për të paguar detyrimet dhe tarifat e vendosura nga shoqata;
- ç) të refuzimit për të shlyer dëmin që i është shkaktuar pronësisë së shoqatës.

Neni 21

Largimi nga detyra i anëtarëve të këshillit administrativ

1. Mbledhja e përgjithshme voton për largimin nga detyra të të gjithë ose të disa prej anëtarëve të këshillit administrativ dhe/ose kryetarit për:

- a) shkelje të rëndë të detyrës; ose
- b) çështje të tjera, të cilat janë parashikuar në statut.

2. Në rast së anëtari i këshillit administrativ largohet nga detyra gjatë një sesioni të mbledhjes së përgjithshme, e njëjta mbledhje cakton menjëherë zëvendësuesin. Në rast së kryetari zgjidhet nga këshilli administrativ mes anëtarëve të këtij të fundit, statuti parashikon që këshilli administrativ të heqë kryetarin mbi bazën e arsyeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe sanksionet

1. Shoqata parashikon në statut dispozita për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe zbatimin e sanksioneve kundër anëtarëve që shkelin statutin e shoqatës, rregullat e brendshme ose rregulloret e lëshura në bazë të statutit. Këto sanksione përfshijnë gjoba, pezullim dhe përjashtim.

2. Shoqata parashikon në statut që mbledhja e përgjithshme ose këshilli administrativ të përcaktojë rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Statuti parashikon që zgjidhja e mosmarrëveshjeve të bëhet nga:

- a) një grup i posaçëm ose nga një juri e dalë prej anëtarëve që caktohen nga mbledhja e përgjithshme;
- b) Departamenti Mbikëqyrës;
- c) ndonjë palë e tretë e pavarur.

Neni 23

Bashkimi i shoqatave

1. Dy ose më shumë shoqata mund të bashkohen për të formuar një shoqatë të vetme, në përputhje me statutin përkatës të tyre dhe vendimet e mbledhjeve të përgjithshme të shoqatave, të krijuara në bazë të kësaj ligji dhe të Kodit Civil.

2. Shoqata e bashkuar regjistron në gjykatë të gjitha pasuritë e shoqatave që janë bashkuar në të.

KREU IV

FEDERATAT E PËRDORUESVE TË UJIT

Neni 24

Krijimi i federatës

1. Federatat janë bashkimi i shoqatave jofitimprurëse për të administruar dhe shfrytëzuar të njëjta burime kryesore ujitëse.

2. Federatat krijohen vullnetarisht prej shoqatave me interesa të përbashkëta. Çdo shoqatë, e cila furnizohet me ujë nga një kanal kryesor ose rezervuar, që shfrytëzohet nga një federatë, gëzon të drejtën të anëtarësohet në atë federatë. Ajo dërgon statutin e vet në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe pas miratimit prej saj, federata regjistrohet në gjykatën përkatëse.

3. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit miraton rregullore për procedurat që duhen ndjekur për krijimin e federatave.

Neni 25

Detyrat e federatës

Detyrat e federatës janë:

a) Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e kanaleve kryesore, rezervuarëve dhe e infrastrukturës përkatëse.

b) Furnizimi me ujë për ujitje i shoqatave anëtare ose joanëtare të federatës.

c) Veprimtari ndërtimi, të nevojshme për të arritur qëllimet e renditura në pikat a) dhe b) të këtij neni.

ç) Mbledh dhe të administron pagesat e anëtarëve dhe joanëtarëve si shkëmbim i shërbimeve të kryera nga federata, përfshirë këtu edhe ndonjë kosto të rastit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së kanalit kryesor, rezervuarit apo të infrastrukturës përkatëse.

Neni 26

Parimet e funksionimit të federatës

Federata funksionon në bazë të parimeve të mëposhtme:

a) Cakton një pjesë të barabartë rezerve ujore për çdo shoqatë anëtare, në varësi të sasisë së ujit që ka gjendje dhe të zonës nën ujitje për secilën shoqatë anëtare.

b) Çdo shoqatë anëtare e një federate paguan në mënyrë përpjesëtimore koston e shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes nga federata.

Neni 27

Statuti i federatës

1. Çdo federatë harton statutin e vet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Statuti rregullon organizimin dhe funksionimin e federatës, si dhe:

a) përshkruan kanalën kryesor dhe rezervuarin ose çdo rezervë ujore, nëse ka të tillë, që shfrytëzohet nga federata, në varësi të planimetrive dhe hartave;

b) përmban emrin dhe selinë e federatës;

c) përcakton strukturën organizative të federatës;

ç) përmban dispozita për kushtet dhe natyrën e anëtarësisë;

d) përcakton të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të federatës, përfshirë këtu edhe të drejtën e tyre të votës.

3. Ndryshimet në statutin e federatës kryhen në përputhje me Kodin Civil. Çdo propozim për ndryshimin e statudit të federatës miratohet nga këshilli administrativ dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. Federata depoziton statutin e ndryshuar në gjykatën përkatëse brenda 30 ditëve nga marrja e miratimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 28

Organizimi i federatës

1. Çdo federatë përbëhet nga këshilli administrativ dhe kryetari.
2. Federata ka të drejte të parashikojë në statut krijimin dhe funksionimin e organeve të tjera shtesë si këshilli ekzekutiv, komisioni i kontrollit financiar, si dhe grup arbitrash.

Neni 29

Këshilli administrativ

1. Këshilli administrativ është organi kryesor vendimor i federatës dhe mbledhjet e këshillit administrativ zhvillohen çdo muaj, nëse statuti nuk parashikon ndryshe. Mbledhjet thirren sipas kërkesës së kryetarit ose një të tretës së anëtarëve të këtij këshilli. Vendimet e këshillit administrativ merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm dhe vota e kryetarit është vendimtare në rast barazie votash. Statuti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit administrativ, të cilët duhet të jenë të pranishëm, për të arritur shumicën e duhur për fillimin e mbledhjes.

2. Statuti vendos për numrin e anëtarëve që ka të drejtë të emërojë çdo shoqatë në këshillin administrativ të federatës dhe numrin e votave që ata duhet të kenë në mbledhjet e këtij këshilli.

3. Këshilli administrativ zgjedh nga radhët e anëtarëve të vet kryetarin, i cili kryeson mbledhjet e këtij këshilli. Të drejtat dhe detyrat e kryetarit përcaktohen në statut.

4. Detyrat e këshillit administrativ përfshijnë:

- a) miratimin e kontabilitetit, të raportit vjetor dhe buxhetit të propozuar;
- b) miratimin e planit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së veprave kryesore ujitëse;
- c) miratimin e programit të shpërndarjes së ujit dhe të planit të ujitjes;
- ç) miratimin e nivelit të tarifave dhe të sanksioneve që vendos federata;
- d) miratimin e rregullores së brendshme dhe të rregullores së funksionimit brenda kuadrit të statutit;
- dh) përgatitjen e kontratave në përputhje me buxhetin e miratuar, me planin e punës dhe me planin e shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes;
- e) ndjekjen e funksionimit të federatës;
- ë) ndjekjen e procedurave financiare të federatës;
- f) çështje të tjera që janë përcaktuar në statut.

Neni 30

Këshilli ekzekutiv

1. Krijimi dhe funksionimi i këshillit ekzekutiv, përbërja e stafit dhe kohezgjatja e emërimit të tyre përcaktohen në statutin e federatës ose me vendim të këshillit administrativ.

2. Në këshillin ekzekutiv të federatës përfshihen kryetari, sekretari i përgjithshëm, kryellogaritari, mbikëqyrësi dhe një mjeshtër ujërash. Detyrat, kompetencat dhe përkrahimi i

punës së këtyre punonjësve detajohen në statut ose me vendim të këshillit administrativ të federatës.

Neni 31

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të federatës përcaktohen në statut.

Neni 32

Tarifa që paguhet nga anëtarët e federatës

1. Statuti i çdo federate përcakton që çdo anëtar i saj duhet të paguajë tarifat e mëposhtme:

a) Tarifat e furnizimit me ujë për ujitje, të bazuara në sasinë e ujit në zonën që është ujitur dhe numrin e ujitjeve të bëra prej anëtarëve të tyre.

b) Shpenzimet e shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes së kanalit kryesor dhe të rezervuarit ose çdo rezerve tjetër ujore të shfrytëzuar dhe mirëmbajtur nga federata.

c) Tarifat e kullimit.

ç) Kuotë anëtarësie vjetore.

d) Çdo tarifë tjetër të vendosur nga federata.

2. Statuti parashikon pagesën e tarifave me këste dhe i lejon federatës të vendosë edhe interes mbi pagesat e prapambetura.

Neni 33

Largimi dhe përjashtimi i anëtarëve

1. Një shoqatë anëtare e një federate ka të drejtën të largohet nga federata, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon që një e drejtë e tillë nuk ushtrohet deri në fund të stinës së ujitjes. Nëse federata bën shpenzime të veçanta për projektimin, ndërtimin, ripajisjen ose funksionimin e një sistemi ujitës, si pasojë e anëtarësisë së një shoqate, kjo e fundit nuk largohet nga federata derisa t'i ketë paguar të gjitha shpenzimet në fjalë.

2. Çdo shoqatë përjashtohet nga federata me vendim të këshillit administrativ në përputhje me statutin, për shkak:

a) të shkeljeve sistematike të akteve ligjore dhe nënligjore, të rregullave dhe të rregullores së brendshme të funksionimit të federatës;

b) të vonesës në pagesën e detyrimeve dhe të tarifave të vendosura nga federata;

c) të refuzimit për të paguar detyrimet dhe tarifat e vendosura nga federata;

ç) të refuzimit për të shlyer dëmin e shkaktuar pronësise së federatës.

3. Një shoqatë që largohet nga një federatë ose që përjashtohet në përputhje me pikën 2 të këtij neni, mbetet përgjegjëse për tarifat e papaguara dhe pagesat që i detyrohet federatës. Kjo e fundit kërkon pagimin e këtyre detyrimeve në gjykatë dhe në këto kushte nuk e furnizon me ujë shoqatën derisa ajo të paguajë të gjitha detyrimet e prapambetura.

Neni 34

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe sanksionet

1. Federata parashikon në statut dispozita për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe zbatimin e sanksioneve kundër anëtarëve që shkelin statutin e federatës ose rregullat dhe rregulloret brendshme të lëshuara në bazë të statutit. Këto sanksione përfshijnë gjoba, pezullim dhe përjashtim.

2. Federata parashikon në statut që këshilli administrativ të përcaktojë rastet parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Statuti parashikon që zgjidhja e mosmarrëveshjeve bëhet nga:

- a) një grup i posaçëm i përbërë nga anëtarë të këshillit administrativ dhe i caktuar nga këshilli administrativ;
- b) një grup i posaçëm i përbërë nga persona të tjerë;
- c) një arbitër i paanshëm si Departamenti Mbikëqyrës, kryetari i komunës apo i këshillit të rrethit.

KREU V

BORDET E KULLIMIT

Neni 35

Bordet e kullimit

1. Bordet e kullimit krijohen në përputhje me këtë ligj si persona juridikë publikë kanë për qëllim të kryejnë detyrat e parashikuara në të.

2. Çdo bord kullimi krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e bordit të kullimit përmban tipin e bordit, zonën nën kullim që do të mbulojë dhe përbërjen e bordit të përfaqësuesve.

Neni 36

Tipet e bordeve të kullimit

1. Bordi kullimit krijohet si bord këshillimor kullimi, si bord i financuar nga buxhi shtetor ose si bord më vetëfinansim.

2. Me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave ndryshon tipin e bordit të kullimit.

Bordi këshillimor i kullimit

1. Bordi këshillimor i kullimit ka për detyrë të mbikëqyrë funksionimin e drejtorive të ujërave në rreth ose të drejtorive të ujërave të rretheve, të cilat veprojnë brenda zonës nën kullim të këtij bordi dhe të këshillojë Ministrin e Bujqësisë dhe Ushqimit për veprimtarinë dhe përmbushjen e detyrave nga ana e tyre. Këshillat kanë të bëjnë me:

a) projektbuxhetin dhe planin e punimeve të drejtorisë së ujërave në Ministri ose të drejtorive të ujërave të rretheve përkatëse;

b) bilancet vjetore të drejtorisë së ujërave në rreth;

c) strukturën organizative dhe nivelin tekniko-profesional të stafit të drejtorisë së ujërave në rreth;

ç) zbatimin e buxhetit dhe të planit të punimeve.

2. Bordi mbledhet të paktën tri herë në vit dhe përcakton rregullat procedurale. Vendimet merren me votim, ku çdo anëtar ka të drejtën e një vote dhe vota e kryetarit është vendimtare në rast barazie votash. Për marrjen e vendimeve është e nevojshme prania e të paktën gjysmës së anëtarëve.

3. Drejtori i drejtorisë së ujërave të rrethit ka të drejtën të ndjeke mbledhjet e bordit, por nuk ka të drejtë vote.

4. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit:

a) miraton statutin e çdo bordi këshillimor kullimi;

b) monitoron veprimtarinë financiar të çdo bordi këshillimor;

c) shqyrton dhe merr vendime për këshillimet e dhëna nga bordet këshillimore të kullimit.

Përbërja e bordit këshillimor të kullimit

1. Çdo bord këshillimor kullimi përbëhet të paktën nga:

a) dy përfaqësues të shoqatave/federatave që funksionojnë brenda zonës nën shërbimin e kullimit, të përzgjedhur nga shoqatat/federatat mes anëtarëve të tyre;

b) përfaqësues të rretheve brenda të cilëve ndodhet zona nën kullim, të emëruar nga këshilli i rrethit;

c) përfaqësues nga komuna, të ndodhura brenda zonës së shërbimit të kullimit dhe të cilat përfitojnë prej kullimit, të zgjedhura nga komunat;

ç) përfaqësues të bashkive të ndodhura brenda zonës së shërbimit të kullimit dhe e cila/ të cilat përfitojnë prej shërbimit, të zgjedhur nga bashkitë;

d) përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, të emëruar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Drejtori i Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujërave dhe Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mund të caktojnë përfaqësues, të cilët duhet të ndjekin mbledhjet e bordit këshillimor të kullimit si vëzhgues, por pa të drejtë vote.

3. Këshilli i Ministrave cakton ose zgjedh përfaqësues të tjerë të grupeve përfituese

prej grupeve të renditura në pikën 1 të këtij neni, apo grupe të tjera që përfitojnë nga shërbimi në fjalë.

4. Këshilli i Ministrave përcakton përbërjen e bordit këshillimor të kullimit.

5. Çdo bord këshillimor kullimi ka një kryetar, i cili emërohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

6. Anëtarëve të bordit këshillimor të kullimit u paguhen shpenzimet ose një pagë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Bordet e kullimit me financim nga buxheti i shtetit

1. Bordi i kullimit me financim nga buxheti i shtetit shfrytëzon dhe mirëmban çdo sistem kullimi dhe veprë mbrojtjeje nga përmytja brenda zonës përkatëse nën shërbim, në mënyrë që të largojë ujën e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit dhe të parandalojë përmytjen.

2. Bordi i kullimit me financim nga buxheti i shtetit, brenda zonës së vet nën shërbim:

a) pastron dhe mirëmban kanalet kulluese, mbledhëse, tubat dhe strukturat;

b) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit hidrovoret);

c) kontrollon cilësinë e ujit që kullohet;

ç) kontrollon, mbikëqyr, mirëmban dhe rregullon sistemet kryesore të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja;

d) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të;

dh) përgatit një plan periodik dhe të azhornuar të emergjencës nga përmytja;

e) mirëmban veprat mbrojtëse detare dhe lumore.

3. Buxheti vjetor i çdo bordi kullimi të financuar nga buxheti i shtetit miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit në bazë të propozimit të bordit të përfaqësuesve.

Neni 40

Bordi i kullimit me vetëfinancim

1. Bordi i kullimit me vetëfinancim shfrytëzon dhe mirëmban çdo sistem kullimi dhe veprë mbrojtjeje nga përmytja brenda zonës respektive nën shërbim, në bazë të fondeve të mbledhura nga tarifat e kullimit të pagueshme nga grupet që përfitojnë nga shërbimi dhe prej buxhetit të shtetit nëse është e nevojshme, nën drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Bordi i kullimit me vetëfinancim kryen veprimet e parashikuara në nenin 39 pika 2 dhe merr masa për të mbledhur tarifat e kullimit nga përfituesit në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Pa rënë ndesh me pikën 2 të këtij neni, të drejtat dhe detyrat e bordeve të kullimit me vetëfinancim, për të vendosur dhe mbledhur tarifa kullimi prej përfituesve të këtij shërbimi dhe prej grupeve përfituese, do të përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 41

Këshilli i përfaqësuesve

1. Me përjashtim të bordit këshillimor të kullimit, çdo bord kullimi ka një këshill përfaqësuesish, i cili përbëhet nga përfaqësues të grupeve që përfitojnë nga shërbimet e kullimit të ofruara brenda zonës nën shërbim. Këshilli i përfaqësuesve përbëhet nga minimumi shtatë anëtarë dhe maksimumi njëmbëdhjetë anëtarë.

2. Çdo këshill përfaqësuesish ka në përbërje të paktën:

a) dy përfaqësues të shoqatave/federatave që funksionojnë brenda zonës nën shërbimin e kullimit, të zgjedhur nga shoqatat/federatat mes anëtarëve të tyre;

b) përfaqësues të rretheve brenda të cilëve ndodhet zona nën kullim, të emëruar nga këshilli i rrethit;

c) përfaqësues nga komuna të ndodhura brenda zonës së shërbimit të kullimit që përfitojnë prej kullimit, të zgjedhura nga komunat;

ç) përfaqësues të bashkive të ndodhura brenda zonës së shërbimit të kullimit që përfitojnë prej shërbimit, të zgjedhur nga bashkitë;

d) përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, të emëruar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Drejtori i Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujërave dhe Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mund të caktojnë përfaqësues, të cilët duhet të ndjekin mbledhjet e bordit të përfaqësuesve si vëzhgues, por pa të drejtë vote

4. Këshilli i Ministrave cakton ose zgjedh përfaqësues të tjerë të grupeve përfituese prej grupeve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, apo grupe të tjera që përfitojnë nga shërbimi në fjalë.

5. Në rastin e bordit të kullimit me vetëfinancim, Këshilli i Ministrave përcakton përbërjen e këshillit të përfaqësuesve në bazë të grupeve përfituese nga shërbimi që përfaqësohen në përpjesëtim me kontributin përkatës në shpenzimet e funksionimit të bordit të kullimit.

6. Çdo anëtar i këshillit të përfaqësuesve emërohet për një afat prej tre vjetësh, me të drejtë riemërimi.

7. Çdo këshill përfaqësuesish ka një kryetar. Në rastin e bordeve të kullimit me financim nga buxheti i shtetit, kryetari i këshillit përfaqësues emërohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit. Në rastin e bordeve të kullimit me vetëfinancim, kryetari zgjidhet nga këshilli i përfaqësuesve mes anëtarëve të këtij të fundit, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në një vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Anëtarëve të këshillit të përfaqësuesve u paguhen shpenzimet ose një pagë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 42

Detyrat e këshillit të përfaqësuesve të bordit të kullimit me financim nga buxheti i shtetit

1. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të kullimit me financim nga buxheti i shtetit i raporton Ministrin të Bujqësisë dhe Ushqimit për funksionimin e bordit të kullimit. Detyrat e këtij këshilli janë:

- a) propozimi i drejtorit të bordit të kullimit;
- b) miratimi i projektbuxhetit dhe raportit vjetor;
- c) miratimi i planit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes;
- ç) miratimi i një plani pune dhe i personelit;
- d) vlerësimi i kontratave në përputhje me buxhetin e miratuar, planin e punës dhe planin e shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes;
- dh) ndjekja e funksionimit të bordit të kullimit;
- e) çështje të tjera të përcaktuara në statut.

2. Statuti i bordeve të kullimit me financim nga buxheti i shtetit miratohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Këshilli i përfaqësuesve mbledhet të paktën një herë në muaj. Vendimet e keshillit të përfaqësuesve merren me votim dhe secili prej anëtarëve ka të drejtën e një vote. Vota e kryetarit është vendimtare në rast barazie votash. Për marrjen e vendimeve është e nevojshme prania e të paktën gjysmës së anëtarëve.

4. Drejtori ekzekutiv i bordit të kullimit ndjek mbledhjet e keshillit të përfaqësuesve, por nuk ka të drejtë vote.

5. Çdo bord kullimi me financim nga buxheti i shtetit mban llogari dhe regjistra në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për kontabilitetin.

Neni 43

Detyrat e keshillit të përfaqësuesve të bordit të kullimit me vetëfinancim

1. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të kullimit me vetëfinancim është përgjegjës ndaj grupeve që përfitojnë nga shërbimet e bordit të kullimit. Detyrat e tij janë të njëjta me detyrat e keshillit të përfaqësuesve të bordit të kullimit me financim nga buxheti i shtetit, të parashikuara në pikën 1 të nenit 42, me përjashtimin që bordet e rregulluara në këtë nen kanë gjithashtu kompetencën që:

- a) të miratojë buxhetin e vet dhe llogaritë vjetore;
- b) të aplikojë në Këshillin e Ministrave për të marrë fonde.

2. Statuti i bordeve të kullimit me vetëfinancim miratohet nga keshilli i përfaqësuesve të bordit të kullimit dhe një kopje depozitohet në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Këshilli i përfaqësuesve mbledhet të paktën një herë në muaj. Vendimet e keshillit të përfaqësuesve merren me votim dhe secili prej anëtarëve ka të drejtën e një vote. Vota e kryetarit është vendimtare në rast barazie votash. Për marrjen e vendimeve është e nevojshme prania e të paktën gjysmës së anëtarëve.

4. Drejtori ekzekutiv i bordit të kullimit me vetëfinancim merr pjesë në mbledhjet e keshillit të përfaqësuesve, por nuk ka të drejtë vote.

5. Çdo bord kullimi me vetëfinancim mban llogaritë e veta dhe regjistra në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për kontabilitetin.

Neni 44

Statuti i bordeve të kullimit

1. Statuti i çdo bordi kullimi rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij bordi. Statuti, gjithashtu:

a) përshkruan zonën nën shërbimin përkatës të bordit të kullimit, referuar planimetrive dhe hartave;

b) përmban emrin dhe selinë e bordit të kullimit;

c) në rastin e bordit të kullimit me financim nga buxheti i shtetit ose të bordit të kullimit me vetëfinancim, përcakton strukturën organizative të bordit të kullimit dhe përshkruan detyrat e drejtorit ekzekutiv;

ç) përmban dispozita për të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të bordit të përfaqësuesve;

d) përmban dispozita për mbledhjet e bordit të përfaqësuesve.

2. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit ndryshon statutin e një bordi këshillimor kullimi dhe me kërkesën e bordit të përfaqësuesve ndryshon statutin e një bordi kullimi të financuar nga buxheti i shtetit, si dhe miraton ndryshime në statutin e bordeve të kullimit me vetëfinancim.

Neni 45

Staffi i bordeve të kullimit

Bordet e kullimit me financim nga buxheti i shtetit dhe bordet e kullimit me vetëfinancim marrin në punë staf punonjësish. Përbërja e stafit dhe kohëzgjatja e emërimit të tyre përcaktohen në statut ose me vendim të bordit të përfaqësuesve.

KREU VI

MBIKËQYRJA E SEKTORËVE TË UJITJES DHE TË KULLIMIT

Neni 46

Llogaritë dhe regjistrat

1. Çdo shoqatë mban llogaritë dhe regjistrat e mëposhtëm:

a) Regjistër të anëtarëve, i cili përshkruan madhësinë dhe vendndodhjen e pronës së çdo pronari; regjistri rishikohet dhe plotësohet çdo tre muaj.

b) Plan që tregon zonën e shërbimit nën ujitje.

c) Regjistër për joanëtarët të cilët furnizohen me ujë.

ç) Regjistër për sasi të ujit të marrë prej shoqatës.

d) Regjistër për sasi të ujit ose numrin e ujitjeve të përfituara nga anëtarët dhe joanëtarët.

dh) Regjistër për pagesat e detyruara, tarifat për t'u paguar dhe ato të paguara.

e) Regjistër për procesverbalet e mbledhjeve të këshillit administrativ.

ë) Regjistër për transaksionet dhe kontratat.

- f) Inventar të pasurive.
 - g) Regjistër për inspektimet dhe kontrollet e kanaleve kryesore dhe/ose të sistemeve të ujitjes, të cilat i janë transferuar shoqatës.
 - gj) Llogaritë financiare sipas nenit 47.
2. Çdo federatë mban llogaritë dhe regjistrat e mëposhtëm:
- a) Regjistër të anëtarëve.
 - b) Plan që tregon kanalin kryesor, rezervuarin ose rezerva të tjera ujore të shfrytëzuar dhe të mirëmbajtura nga federata.
 - c) Regjistër për joanëtarët, të cilët furnizohen me ujë.
 - ç) Regjistër për sasitë e ujit të marrë nga anëtarët dhe joanëtarët.
 - d) Regjistër për pagesat e detyruara, tarifatat për t'u paguar dhe ato të paguara.
 - dh) Regjistër për procesverbalet e mbledhjeve të këshillit administrativ.
 - e) Regjistër për transaksionet dhe kontratat.
 - ë) Inventar të pasurive.
 - f) Regjistër për inspektimet dhe kontrollet e kanaleve kryesore dhe infrastrukturës që i është transferuar federatës.
 - g) Llogaritë financiare sipas nenit 47.
- 3 a) Bordi kullimit mban regjistrat dhe librat e mëposhtëm:
- planimetrinë që tregon zonën nën shërbimin e kullimit;
 - regjistrin e anëtarëve të bordit të përfaqësuesve;
 - regjistrin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të përfaqësuesve.
- b) Bordet e kullimit me financim nga buxheti i shtetit dhe bordet e kullimit me vetëfinancim mbajnë edhe regjistrat e mëposhtëm:
- regjistrin e kontratave të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe ndërtimit;
 - inventarin e pasurive;
 - regjistrin për inspektimet në kanalet kryesore kulluese dhe të veprave të mbrojtjes nga përmytja të transferuar në bordin e kullimit;
 - llogaritë financiare sipas nenit 47.
- c) Bordi i kullimit me vetëfinancim mban edhe regjistrin e tarifave të drenimit të paguara ose jo.

Neni 47

Llogaritë financiare

1. Çdo shoqatë, federatë, bord kullimi me financim nga buxheti i shtetit ose me vetëfinancim mban llogari të faturave dhe shpenzimeve, si dhe përgatit bilancin vjetor dhe raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve.
2. Bilanci vjetor dhe raporti i të ardhurave dhe shpenzimeve miratohet çdo vit:
 - a) në rastin e shoqatës, nga mbledhja e përgjithshme;
 - b) në rastin e federatës, nga këshilli administrativ;
 - c) në rastin e bordit të kullimit të financuar nga buxheti i shtetit, nga bordi i përfaqësuesve dhe Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit;
 - ç) në rastin e bordit të kullimit me vetëfinancim, nga bordi i përfaqësuesve.
3. Dokumentacioni financiar i çdo bordi këshillimor kullimi mbahet nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Kontrolli financiar i llogarive dhe i të ardhurave vjetore

1. Llogaritë e çdo shoqate, federate, bordi kullimi me financim nga buxheti i shtetit dhe bordi kullimi me vetëfinancim, që përfshijnë bilancin vjetor dhe raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve i nënshtrohen kontrollit vjetor nga Departamenti Mbikëqyrës. Departamenti Mbikëqyrës, me miratimin me shkrim nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit ia delegon kompetencat e veta për kryerjen e kontrollit financiar një enti tjetër të kualifikuar për këtë qëllim.

2. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit mund të caktojë rrethe të cilat u nënshtrohen kërkesave të raportimit, siç janë treguar në pikën 3 të këtij neni. Lajmërimi për caktimin e këtyre rretheve publikohet zyrtarisht.

3. Çdo shoqatë, federatë, bord kullimi me financim nga buxheti i shtetit dhe bord kullimi me vetëfinancim, i cili ka zyrën e vet të regjistruar në njërin prej rretheve të caktuara sipas pikës 2, brenda 120 ditëve nga fundi i vitit financiar, depoziton raportin e të ardhurave vjetore në Departamentin Mbikëqyrës, në formatin e përcaktuar nga ky i fundit, bashkë me një kopje të bilancit të tij vjetor dhe raportit të shpenzimeve, si dhe një tarifë depozitimi, nëse një gjë e tillë parashikohet.

4. Anëtarët e këshillit administrativ të shoqatës apo federatës janë përgjegjës dhe ndëshkohen administrativisht nëse nuk depozitojnë raportin e të ardhurave vjetore dhe kopje të llogarive financiare brenda afatit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordeve të kullimit me financim nga buxheti i shtetit ose të bordit të kullimit me vetëfinancim mbajnë përgjegjësi dhe ndëshkohen administrativisht nëse nuk depozitojnë raportin e të ardhurave vjetore dhe kopje të llogarive financiare brenda afatit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

Regjistri i shoqatave, federatave dhe bordeve të kullimit

1. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit krijon regjistrin e shoqatave, federatave dhe bordeve të kullimit, i cili mbahet nga Departamenti Mbikëqyrës.

2. Regjistri i shoqatës përmban të dhënat e mëposhtme:
- a) emrin e shoqatës;
 - b) selinë e shoqatës;
 - c) zonën përkatëse në shërbim ujitjeje të shoqatës, madhësinë dhe vendndodhjen e zonës së shërbimit të ujitjes së kësaj shoqate;
 - ç) numurin e anëtarëve të shoqatës;
 - d) emrat, adresat, numrat e telefonit (nëse kanë) të anëtarëve të këshillit administrativ dhe të kryetarit;
 - dh) datën e depozitimit të raportit të fundit të të ardhurave.
3. Regjistri i federatës përmban të dhënat e mëposhtme:
- a) emrin e federatës;
 - b) selinë e federatës;

- c) kanalin kryesor dhe të tjera infrastruktura të cilat i janë transferuar federatës;
- ç) anëtarët e federatës;
- d) emrat, adresat, numrat e telefonit (nëse kanë) të anëtarëve të këshillit administrativ dhe të kryetarit;
- dh) datën e depozitimit të raportit të fundit të të ardhurave.
- 4. Regjistri i bordit të kullimit përmban të dhënat e mëposhtme:
 - a) emrin e bordit të kullimit;
 - b) selinë e bordit të kullimit;
 - c) zonën përkatëse të shërbimit të kullimit të bordit të kullimit;
 - ç) emrat, adresat, numrat e telefonit (nëse kanë) të anëtarëve të bordit të përfaqësuesve;
 - d) datën e depozitimit të raportit të fundit të të ardhurave.
- 5. Regjistri i shoqatave kontrollohet nga publiku gjatë orarit normal zyrtar.

Neni 50

Mbikëqyrja ligjore financiare

1. Departamenti Mbikëqyrës kërkon vazhdimisht kopje të balanceve të shoqatave, federatave dhe bordeve të kullimit, së bashku me kopje të regjistrave, të cilat mbahen në përputhje me këtë ligj.
2. Departamenti Mbikëqyrës kontrollon financat dhe regjistrat e shoqatës ose të federatës:
 - a) Në bazë të kërkesës me shkrim të një anëtari të shoqatës ose federatës;
 - b) pasi zbulon prova të shkeljeve financiare ose prova parregullsish në kopjen e raportit të të ardhurave vjetore dhe të llogarive të shoqatës apo federatës përkatëse.
3. Nëse Departamenti Mbikëqyrës gjatë kontrollit financiar të një shoqate, gjen prova të shkeljeve financiare ose prova se shoqata nuk ka funksionuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i kërkon këshillit administrativ të thërrasë një sesion të mbledhjes së përgjithshme, ku u paraqiten anëtarëve shkeljet e vërejtura. Nëse këshilli administrativ nuk thërret një sesion të mbledhjes së përgjithshme brenda 30 ditëve, Departamenti Mbikëqyrës pezullon këshillin administrativ dhe e thërret vetë këtë sesion.
4. Nëse këshilli administrativ pezullohet në përputhje me pikën 3, Departamenti Mbikëqyrës cakton një drejtues të përkohshëm të shoqatës, derisa mbledhja e përgjithshme të caktojë një këshill administrativ.
5. Nëse gjatë kontrollit financiar të një federate, Departamenti Mbikëqyrës gjen prova të shkeljeve financiare ose prova se federata nuk ka funksionuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i kërkon këshillit administrativ të thërrasë një sesion të mbledhjes, ku paraqiten para anëtarëve shkeljet e vërejtura. Nëse këshilli administrativ nuk thërret një sesion të mbledhjes brenda 30 ditëve, Departamenti Mbikëqyrës pezullon këshillin administrativ dhe cakton një drejtues federate të përkohshëm, deri në çastin kur anëtarët e federatës të caktojnë një këshill të ri administrativ.
6. Nëse gjatë kontrollit financiar të bordit të kullimit, Departamenti Mbikëqyrës gjen prova të shkeljeve financiare ose bordi i kullimit nuk ka funksionuar në përputhje me këtë ligj, Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit pezullon bordin e përfaqësuesve dhe cakton një drejtues të përkohshëm të bordit të përfaqësuesve, derisa të caktohet një bord i ri i përfaqësuesve.

Neni 51

Mbikëqyrja teknike

1. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit u kërkon shoqatave, federatave dhe bordeve të kullimit të dhëna dhe dokumentacion mbi shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës që i është transferuar atyre në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit autorizon stafin e vet të kontrollojë infrastrukturën që është transferuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe i kërkon shoqatës, federatës ose bordit të kullimit të marrë përsipër punime specifike, kur kjo është e nevojshme:

- a) për të siguruar mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture;
- b) për të parandaluar dëmet ose cenimin e kësaj infrastrukture;
- c) për të parandaluar dëmet e pronës shtetërore ose dëmet e pronës së të tretëve;
- ç) në interes publik.

Neni 52

Servitutet

1. Shoqata, federata dhe bordi i kullimit përfiton servitut në përputhje me Kodin Civil.

2. Shoqata, federata ose një bord kullimi autorizojnë persona, të cilët kanë të drejtë të hyjnë në tokë private për të kryer kontrole dhe punë emergjente për infrastrukturën, e cila i është transferuar shoqatës, federatës ose bordit të kullimit.

3. Sipërfaqja mbi të cilën është vendosur sistemi ujitës dhe kullues, së bashku me strukturat përkatëse, regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, ku bëhet dhe regjistrimi i servituteve të krijuar në bazë të këtij neni. Ndryshime kryhen në rastet e transferimit të infrastrukturës në bazë të urdhrit të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 53

Fondet e emergjencës dhe fondet rezervë

Shoqatat, federata dhe bordet e kullimit me vetëfinancim mund të krijojnë fonde emergjence dhe fonde rezervë dhe të hapin një llogari të veçantë bankare për këto fonde.

Neni 54

Shpërndarja dhe likuidimi i shoqatave dhe federatave

Shpërndarja dhe likuidimi i shoqatave dhe federatave bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Neni 55

Shpërndarja dhe likuidimi i bordeve të kullimit

Një bord kullimi shpërndahet me vendim të Këshillit të Ministrave nëse qëllimi për cilin u ngrit pushon së ekzistuari, ose kur praktikisht detyrat e këtij bordi nuk mund të përmbushen ose kur qenia e mëtejshme e bordit të kullimit nuk nevojitet për arsye të tjera. Këshilli i Ministrave në marrjen e një vendimi të tillë përcakton procedurat që ndiqen për likuidimin e bordit të kullimit.

Neni 56

Kundërvajtje administrative

1. Përbëjnë kundërvajtje administrative, kur nuk formojnë vepër penale dhe ndëshkohen si të tilla:
 - a) ndërtimi, rehabilitimi ose modifikimi i një sistemi ujitjeje apo kullimi pa lejë përkatëse;
 - b) dëmtimi i sistemit të ujitjes, i sistemit të kullimit ose të veprave të mbrojtjes nga përmytja;
 - c) ndërtimi i paautorizuar mbi sistemet e ujitjes, sistemet e kullimit ose veprave mbrojtjeje nga përmytja;
 - ç) ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve më pak se tetë metra nga bordura e kanalit kryesor ose një sistemi kryesor kullimi ose më pak se katër metra nga bordura e çfarëdo kanali ujitjeje ose kullimi.
2. Zbulimi, përshkrimi dhe denoncimi i kundërvajtjeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, do të bëhet nga shoqatat, federatat dhe bordet e kullimit, ndërsa shqyrtimi, gjykimin dhe dënimi i tyre bëhet nga kryetari i degës së policisë së ndërtimit të rrethit përkatës ku është kryer kundërvajtja.
3. Kundërvajtësi është i detyruar të përballojë shpenzimet për rikthimin e objektit dëmtuar në gjendjen e mëparshme.
4. Kundërvajtjet administrative, sipas nenit 56 të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 57

Kundër vendimeve të kryetarit të degës së policisë së ndërtimit në rreth mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit pranë drejtorit të policisë së ndërtimit, i cili duhet shprehur brenda 10 ditëve. Kundër vendimit të këtij të fundit mund të bëhet ankim në gjykatë e rrethit ku është kryer kundërvajtja, brenda 5 ditëve nga njoftimi i tij.

Neni 58

Ankimi në gjykatë kundër vendimeve të organeve të policisë së ndërtimit nuk pezullohet ekzekutimin e tyre.

Në rast se në bazë të vendimit përfundimtar të formës së prerë të gjykatës vendose

pranimi i padisë ose i ankimit, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë, nga organi që ka dhënë vendimin, shpërblimin për dëmin e shkaktuar.

Neni 59

Dispozita të fundit

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 60

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 7846, datë 21.7.1994 “Për ndërtimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e veprave të ujitjes dhe kullimit”, si dhe ligji nr.8111, datë 28.3.1996 “Për një ndryshim në ligjin nr.7846, datë 21.7.1994”, si dhe çdo akt tjetër që bie ndesh me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 61

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2439, datë 13.8.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**